



Kingdom of the Netherlands



## **RAPORT**

### **Amnistia Fiskale - Çështje dhe Problematika të Harmonizimit me Legjislacionin Penal**

**Korrik 2022**

Raporti është hartuar nga AIS në kuadër të projektit C1-EU-NPA



Raporti me titull Amnistia Fiskale - Çështje dhe Problematika të Harmonizimit me Legjislacionin Penal është hartuar nga organizata Albanian Institute of Science AIS / Open Data Albania, në zbatim të projektit C1 – EU – NPA “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike”, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster1 Shqipëri. Ky Raport zbardh disa aspekte dhe problematika të harmonizimit dhe sigurse juridike e që lidhen me draft ligjin e propozuar për Amnisti Fiskale dhe Penale të Subjekteve që Bëjnë Deklarim Vullnetar të Pasurive, draft ligj iniciativë e prezantuar për Konsultim Publik në datën 23 qershor 2022 me afat për Medime dhe Rekomandime deri 23 Korrik.

Projekti C1 – EU – NPA zbatohet nga katër organizata shqiptare: Center for the Study of Democracy and Governance CSDG, Instituti i Studimeve Politike ISP, Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH dhe Albanian Institute of Science AIS, me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në Tiranë.

Raporti prezantohet si pjesë e iniciativave të shoqërisë civile, që synojnë të japin kontributin e tyre në integrimin europian të vendit.

Gjetjet, Opinione apo Rekomandimet e shprehura në këtë Raport përfaqësojnë këndvështrime të ekspertëve dhe organizatës AIS dhe nuk përkohjnë me përgjegjësi të partnerëve apo mbështetësve të Projektit C1-EU-NPA.



## Hyrje e shkurtër

Eksperti i njohur George Gutman duke punuar për Internal Revenue Service IRS në SHBA ka shkruar se amnistia, sikundër zjarri që ndizet nga ne vetë për të vënë në kontroll zjarret masive në pyje, është potencialisht një mjet i rrezikshëm për sistemin e taksave. Por nëse përdoret me kujdes mund të shërbejë si përtëritës për vitalizimin e sistemit të taksave.

Shqetësimi më i madh për autoritetet vendimmarrëse dhe më pas ato zbatuese, kur diskutojnë për të vendosur për një program amnistie ose jo, është fakti se tatimpaguesi i ndershëm do të humbasë respektin për integritetin e sistemit të taksave në vend. Integriteti fokusohet në imazh, efektivitet, eficence dhe kredibilitet të sistemit. Kjo parashtrohet çështjen e një balance delikate për vendimmarrje dhe zbatim. Një anë autoritetet dëshirojnë të bëjnë amnistinë fiskale sa më atraktive me qëllim që të tërheqin sa më shumë tatimpagues jo të rregullt për t'u përfshirë në amnistia. Nga ana tjetër, po të njëjtët autoritete nuk duan ta bëjnë atraktiv programin aq sa tatimpaguesit e rregullt të humbasin besimin tek shteti dhe për më keq edhe ata që janë të rregullt të bëhen tatimpagues jo të rregullt.

## Harmonizimi me legjislacionin penal

Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*vendimi nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*vendimet nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 10, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma janë të pajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*vendimi nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 60, datë 16.09.2016*).

I. Projektligji “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” përcakton se:

### *Neni 2*

*Qëllimi i këtij ligji është:*



d) garantimin për mosfillimin e procedurave administrative dhe të procedimeve penale ndaj këtyre subjekteve, nga ana e institucioneve përkatëse, në lidhje me këto pasuri.

### **Neni 20**

#### **Efektet e përfundimit të procedurës së deklarimit vullnetar**

2. Subjekte përfitues sipas parashikimeve të këtij ligji, pas pajisjes me vërtetimin e përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar, përfitojnë këto të drejta:

dh) Përrjashtim nga ndjekja penale dhe procedimi penal, në kuadër të ligjit penal të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, për vepra penale në fushën tatimore dhe e doganave nga të cilat burojnë që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi pasuritë e deklaruara sipas kushteve dhe parashikimeve të këtij ligji;

### **Neni 22**

#### **Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale**

1. Subjektet përfituese, ndaj të cilave është lëshuar vërtetimi përkatës i përfundimit të procesit të deklarimit vullnetar, përjashtohen nga ndjekja penale për veprat penale në fushën tatimore dhe e doganave që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me krijimin dhe disponimin e pasurisë së deklaruar, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, të kryera deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Legjislacioni shqiptar ndër vite përjashtimin nga përgjegjësia penale e ka bërë nëpërmjet miratimit të dispozitave të veçanta në Kodin Penal. (për ata persona që nuk kanë vendim penal gjykatë të formës së prerë ose procedim penal të regjistruar që është rasti klasik i amnistive penale). Kështu në Kodin Penal, ndër vite, është parashikuar përjashtimi nga përgjegjësia penale në këto dispozita:

### **Neni 52/b**

#### **Përrjashtimi nga dënimi për krimet në fushën e zgjedhjeve**

Personi që ka kryer një ose më shumë vepra penale të parashikuara në kreun X, të këtij Kodi, I cili bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale për hetimin, si dhe për zbulimin e personave të tjerë, bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale ose autorë të veprave të tjera të lidhura, përjashtohet nga dënimi për veprën penale të kryer prej tij.

### **Neni 334/1**

Pavarësisht nga neni 278, përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake personat që në përputhje me legjislacionin në fuqi, dorëzojnë vullnetarisht armët deri më datën 31.5.2005.

Në çdo rast nuk përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje personat që kanë kryer veprë penale, duke përdorur si mjet për këtë qëllim armë dhe municione luftarake.



*Nuk përjashtohen nga ndjekja penale edhe personat të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deklarojnë se nuk kanë armë e municione luftarake dhe nga kontrollet e ushtruara në mbështetje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale u gjenden armë e municione të fshehura.*

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. (vendimi nr. 1, datë 12.01.2011)

Pavarësisht se projektligji në fjalë është parashikuar që të miratohet me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për shkak se ekziston rreziku se një shpërndarje e tillë normash të sjellë inflacion për përjashtimin nga përgjegjësia penale, për shkak të pasaktësive në formulim zbatim, si dhe nevojës së përqendrimit si të çështjeve të përgjegjësive penale ashtu edhe të mungesës së saj brenda një teksti unik ligjor, është e rekomandueshme që edhe përjashtimi nga përgjegjësia penale për hir të “amnistisë fiskale” të bëhet me nen të veçantë në Kodin Penal.

II. Projektligji “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” përcakton se:

#### **Neni 22**

#### ***Kushtet për dhënien e amnistisë nga ndjekja penale***

2. *Subjektet përfituese, ndaj të cilave është lëshuar vërtetimi përkatës i përfundimit të procesit të deklaramit vullnetar, përjashtohen nga ndjekja penale për veprat penale në fushën tatimore dhe e doganave që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me krijimin dhe disponimin e pasurisë së deklaruar, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, të kryera deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

Për hir të qartësisë së tekstit ligjor dhe zbatimit sa më të saktë të tij në praktikë është e nevojshme që të citohen shprehimisht dispozitat e Kodit Penal për të cilat zbatohet përjashtimi nga vepra penale. Projektligji duhet të parashikojë edhe ato raste kur dënimi penal për veprat penale në fushën tatimore dhe doganore i është bashkuar procedimit për një vepër tjetër penale.

III. Neni 287 i Kodit Penal përcakton se:

#### **Neni 287**

#### ***Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale***

*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:*

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;*



- ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;*  
*d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;*  
*dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.*

*Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:*

- a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si I pandehur ose që nuk mund të dënohet;*  
*b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;*  
*c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;*  
*ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;*  
*d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.*

*Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.*

Projektligji “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” nuk saktëson raportin e tij me zbatimin e nenit 287 të Kodit Penal. Pavarësisht se në të përcaktohet se personat që janë në fushën e zbatimit të tij përjashtohen nga përgjegjësia penale për veprat/procedimet e shkaktuara në fushën e taksave, tatimeve apo të doganave, ata përsëri nuk mund të amnistohen fiskalisht sepse ende mbajnë përgjegjësi penale për konsumim të nenit 287 të Kodit Penal. Neni 287 i Kodit Penal zbatohet njëjloj edhe nëse personi psh që ka kryer evazion fiskal në fushën e doganave nuk mund të dënohet pikërisht për shkak të amnistisë penale që parashikon projektligji.

**IV.** Projektligji “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” përcakton se:

#### ***Neni 4***

#### ***Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore***

- 1. Dispozitat e legjislacionit në fushën tatimore dhe doganore, të cilat parashikojnë kompetencat e organeve të administratës publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të fushës, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për fillimin e procedurave administrative, gjatë kohës së zbatimit të këtij ligji, aplikohen në përputhje me këtë ligj.*
- 2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për pasuritë që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.*
- 3. Dispozitat e ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji.*

Në lidhje me përcaktimet e bëra në nenin 4 të projektligjit:

- është i paqartë kuptimi dhe zbatimi i përcaktimit të bërë në pikën 1 të nenit 4. Psh nuk mund të evidentohet një situatë konkrete e cila t'i japë kuptim logjik të përcaktimit të bërë në pikën 1 të tij. Projektligji i publikuar ne faqen zyrtare të konsultimit publik nuk përmban as Relacion dhe as Raport të Vlerësimit të Ndikimit, kërkesë e detyrueshme për zbatim e VKM-së “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”.

- në momentin e miratimit të kësaj amnistie fiskale dhe për 9 muaj të kohëzgjatjes së saj, një person nuk është në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Ndërkohë po ky person përfiton nga “Amnistia Fiskale” dhe legalizon pasuritë e tij, ose një pjesë të tyre dhe psh pas katër vitesh bëhet subjekt i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009. Në këtë rast për pasuritë e amnistuara ligjrisht, për shkak të parimit të sigurisë juridike, nuk mund të veprojë ligji i sipërcituar dhe këto pasuri përsa kohë janë konsideruar dhe njohur nga shteti si të ligjshme nuk mund të jetë subjekt i masave ligjore të sekuestrimit dhe konfiskimit sipas këtij ligji për paligjshmëri në krijimin e tyre.

Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i njohur ndryshe si ligji Antimafia, sikundër e ka konsideruar Gjykata Kushtetuese Italiane dhe Gjykata e Strasburgut nuk është ligj me karakter penal, por ligji i fushës së drejtës civile, ndaj edhe konsiderimi i ligjshëm civilisht nga kjo amnisti i pasurisë së krijuar në kundërshtim me ligjin, nuk mund të vihet më në diskutim për paligjshmëri sipas ligjit Antimafia. Në këtë rast prevalon parimi i sigurisë juridike dhe në të njëjtën kohë edhe ky parashikim në pikën 2 të nenit 4 nuk do të këtë zbatim praktik sepse psh pasuria në fjalë do të hyjë e ligjshme në qarkullimin civil dhe ajo nuk mund të sekuestrohet tek i treti që e ka përfituar atë sipas një veprimi juridik të Kodit Civil dhe që në kohën e transaksionit është e ligjshme.

- Në pikën 3 të nenit 4 është i paqartë formulimi “kanë përparësi”. Nga ana tjetër një ligj me shumicë të thjeshtë nuk mund të mbizotërojë në zbatim në raport me ligjin që miratohet me shumicë të cilësuar nga Kuvendi. Përkundrazi, ligjet me shumicë të cilësuar duhet të mbizotërojnë në zbatim dhe ligjet me shumicë të thjeshtë duhet të të jenë në harmoni me to.

**V.** Nuk duhet të anashkalohet fakti se Komisioni European ka ngritur së fundmi shqetësime serioze për draftin aktual të ligjit për amnisti fiskale. Sipas Komisionit European ligji në fjalë do të dobësonte kontrollet e Shqipërisë kundër pastrimit të parave, ndërkohë që do të bënte pak për të rritur aftësinë e administratës tatimore për të përmirësuar pajtueshmërinë e ardhshme lidhur me kërkesat tatimore. Për shkak se rezidentët jotatimorë, përfshirë shqiptarët që jetojnë në BE ose në Ballkanin Perëndimor, përfshihen në objektin e tij dhe u kërkohet të importojnë para në dorë për të përfituar nga amnistia, drafti aktual i ligjit ngre shqetësime serioze për shtetet anëtare të BE-së dhe partnerët e tjerë, si dhe një rrezik thelbësor reputacioni për Shqipërinë.

**VI.** Amnistia fiskale dhe penale duhet të mbështetet në eksperiencat më të suksesshme të vendeve të tjera dhe të përshtatet me kontekstin shqiptar. Një amnisti e tillë tatimore dhe penale do të ishte e vështirë për t'u zbatuar sepse përkufizimi i pasurive përfshin elementë të tillë si prona e paluajtshme në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë, paratë cash të mbajtura në monedhën vendase ose të huaj, monedhë



digjitale, sende me vlerë prej ari ose gurë të çmuar etj. (neni 3) dhe për to është e vështirë të garantohet se:

- ato nuk rrjedhin nga aktivitete kriminale;
- deklarohen nga pronari i tyre aktual (përfitues); dhe
- rezultojnë nga të ardhurat të cilat nuk i përkasin një periudhe tatimore që ose është ende subjekt i deklaratës tatimore ose subjekt i një kontrolli tashmë të kryer tatimor.

Është e paqartë për bankat dhe publikun se si ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” do të zbatohet në kontekstin e kësaj amnistie. Ka një rrezik të qartë që projektligji të krijojë hapësira për evazion fiskal dhe pastrimin e parave që vijnë nga jashtë. Ndërkohë bizneset vendase dhe të huaja publikisht kanë shprehur shqetësimin e tyre për konkurrencën e padrejtë nga ata që kanë krijuar pasuritë në mënyrë të kundërligjshme dhe/ose i kanë mbajtur ato jashtë sistemit deri më tani.

**VII.** Neni 20, pika 3 e projektligjit përcakton se: “çdo dispozitë e këtij ligji do të interpretohet në favor të subjekteve përfituese”. Ky formulim është shumë i gjerë dhe lë hapësira për pasoja të shumta. Ndërsa parimi i prezumimit të pafajësisë ndaj të pandehurit është një parim themelor i sundimit të ligjit, në këtë rast rrezikon përjashtimin nga ndjekja penale të subjektit që ka konsumuar një vepër penale tjetër të Kodit Penal.

**VIII.** Në mënyrë që ky ligj amnistie të jetë i besueshëm dhe të jetë i zbatueshëm – dhe të mos rrezikohet humbja e besimit dhe bindjes ndaj ligjit të tatimpaguesve – përmbajtja e tij duhet të kombinohet me rritjen e zbatimit kundër tatimpaguesit që janë në shkelje të ligjit. Ndërkohë që në ende nuk e kemi ndërtuar një administratë tatimore profesionale, e cila do të bllokonte mundësinë për pastrim parash dhe korrupsion.





## Konkluzione

Kualifikimi i projektligjit “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” në rrethin e akteve normative që parashikon neni 81, pika 2, shkronja “ë” e Kushtetutës dhe për pasojë miratimi me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit është i drejtë. Ndërkohë një sërë vendesh si në zhvillim ashtu edhe ato me ekonomi dhe demokraci të konsoliduar kanë miratuar ndër vite disa herë amnisti fiskale. Rasti i Shqipërisë duhet të përfitojë nga standarde më të mira në këtë aspekt dhe njëkohësisht edhe nga mësimet që janë nxjerrë nga zbatimi në këto vende i amnistine fiskale.

Për shkak se miratimi i projektligjit “Për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive” kërkon një shumicë të cilësuar prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, rekomandohet që çështja e diskutimit të amnistisë fiskale dhe kornizave juridike brenda të cilave të hartohet kjo amnisti të bëhet nga një organ i specializuar dhe me përbërje të gjerë politike siç është Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike (ose Komisioni për Ekonominë dhe Financat ose të dy bashkë). Komisioni duhet të miratojë kornizën ligjore brenda së cilës duhet të shtrihet amnistia në formën e një vendimi që të shprehë konsensusin më të gjerë politik të mundshëm.

Vendimi i Komisionit të Përhershëm Parlamentar si më lart duhet të përcaktojë listën e çështjeve që duhet të rregullojë amnistia fiskale dhe penale, fushën dhe subjektet e zbatimit të ligjit, organet e zbatimit të amnistisë dhe modalitete të tjera kryesore të strukturës së një ligji. **Në vijim detyra t’ju ngarkohet ekspertëve teknikë të cilët duhet të përkthejnë këtë vullnet politik në gjuhën teknike ligjore dhe normative.** Është e kuptueshme që procesi, për shkak se zhvillohet në Kuvend, siguron transparencën e nevojshme dhe pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit, ekonomistëve të njohur, akademikëve, etj. Në këtë mënyrë si korniza dhe struktura juridike ashtu edhe procesi i draftimit të projektligjit do të përfitojë nga konsultimet dhe gjithpërfshirja.

Një ligj sado i arrire ne permbajtjen e vet, nuk mund te realizoje efektet e dëshiruara ne rast se mungon vullneti sa më i gjerë i aktorëve politikë në Kuvend. Po ashtu, edhe ne rast se arrihet një vullnet i plote politik përsëri nuk do te mund te realizohen efektet e dëshiruara ne rast se mungon një baze ligjore koherente, e plote dhe e sakte për amnistinë fiskale dhe penale.



### **Në përfundim:**

- Shqipëria nuk është vendi i parë dhe nuk do të jetë vendi i fundit që miraton një ligj të posaçëm për amnistinë fiskale dhe penale, përfshirë edhe dhënien e imunitetit ndaj ndjekjes penale dhe duke përcaktuar subjekte që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të tij.
- Për shkak se ligji miratohet me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit është domosdoshmëri sigurimi i një konsensusi të gjerë politik, që është premisë e një zbatimi korrekt dhe të plotë të ligjit sapo ai të hyjë në fuqi. Për këtë shkak epiqendra e procesit të përgatitjes dhe miratimit të tij, mbi bazën e punës së bërë deri më tani duhet të zhvendoset tek një Komision i përhershëm i Kuvendit.
- Projektligji ka nevojë të rishihet në tërësinë e tij duke akomoduar si reflektim në përmbajtjen e vet si shqetësimet e ngritura deri më tani publikisht në lidhje me të, ashtu edhe në mënyrë të veçantë të garantojë harmonizimin me legjislacionin penal, tatimor, etj.
- Projektligji që duhet të miratohet duhet të jetë në frymën dhe eksperiencën e vendeve të tjera që kanë miratuar ligje për amnisti fiskale dhe penale, dhe duhet të ketë në përmbajtjen e vet edhe zgjidhjen e një sërë mësimesh apo problematikash që këto ligje kanë pasur në zbatim në vendet respektive.